



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2024/0870**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim, paneliste individuale duke vendosur sipas ankesës së OE "Aome " Sh.P.K. kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje në shkolla dhe institucione tjera te Komunës” me numër të prokurimit 634-24-4786-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Komuna e Klinës më 15/11/2024, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohet, si e pabazuar ankesa e OE "Aome " Sh.P.K., me nr. 2024/0870 , e datës 19/09/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me dru për ngrohje në shkolla dhe institucione tjera te Komunës” me numër të prokurimit 634-24-4786-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Klinës.

2. Mbetet ne fuqi Njoftimi mbi Vendimin të Autoritetit Kontraktues - Komuna e Klinës, në lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

3. Urdhërohet konfiskimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP ndërsa mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

#### ***- Faktet dhe rrethanat procedurale –***

Me 23.05.2024 Komuna e Klinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me “Furnizim me dru për ngrohje në shkolla dhe institucione tjera te Komunës” me numër të prokurimit 634-24-4786-1-2-1.

Ndërsa me datën 06.09.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE NTSH Nazi Travel.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 47,500.00 €

Me 11.09.2024 OE "Aome " Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 12.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 19.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Aome " Sh.P.K. me nr. 0870/2024 lidhur me aktivitetin “Furnizim me dru për ngrohje në shkolla dhe institucione tjera te Komunës” me numër të prokurimit 634-24-4786-1-2-1.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Aome " Sh.P.K. janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) : “Në këtë përshkrim të shkeljeve të konstatuara më tepër do të përqendrohem në shkeljet të cilat kanë ndodhur lidhur me Nenin 59 Është shkelur neni 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve) i Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr.04/L-237, ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-92, si dhe nenin 40 të RPP Në njoftimin për kontratë të publikuar ne web faqen e platformës elektronike të KRPP-së te autoritetit kontraktues Komuna e Klinës Republika e Kosovës; dhe në dokumentet të cilat përbëjnë dosjen e tenderit: Ju në B58 — Njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues Dhënie e kontratës publike. Letër Standarde për tenderuesin kandidatin e pasuksesshëm e datës 06/09/2024. Në pajtim të plotë me dispozitat e LPP-së dhe Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimit Publik, nenin 32 paragrafi 32.4 të Rregullores w. 001/2022 për prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues nuk mundë të ndryshoi asnjë aspekt të një tenderi ndërsa, Tenderuesi është përgjegjës për ti ngarkuar te gjitha dokumentet e kërkuara në sistemin elektronik të prokurimit të Kosovës para afatit të fundit për dorëzimin e tenderëve si dhe për të siguruar saktësinë e tenderëve të tyre, bazuar në kërkesat e parashtruara në dokumentin Fleta e të Dhënave të Tenderit (FTD). Në këtë mënyrë Ju si autoritet kontraktues nuk keni respektuar këto kërkesa dhe për pasojë keni bërë devijim thelbësorë nga kërkesat e përcaktuara dhe specifikimet e detyrueshme teknike, gjegjësisht keni bërë devijim qenësor - thelbësorë nga kërkesat e tenderit, gjë që ka bërë që vlerësimi për rregullshmërinë e dëshmime të dorëzuara lidhur me aftësitë teknike dhe lose profesionale të mos jetë i plotë, i rregullt dhe i pranueshëm. Andaj, në pajtim me dispozitat e LPP-së dhe Rregullave për prokurimin publik në Kosovë, oferta e jonë është trajtuar si ofertë e pasuksesshme nga komisioni për vlerësimin e ofertave. Provë: AK- Komuna e Klinës, me date 06.09.2024, përmes platformës elektronike e-prokurim na njofton se ka marrë vendim — 058 Njoftimi mbi vendimin e AK, qe do thotë se me këtë rast ka shkelur dispozitat ligjore te LPP- se, dhe rreg. Nr. 001/20222 për PP të cilën do i argumentoj dhe dëshmojë me prova dhe

fakte konkrete si ne vazhdim te kësaj KR. Paragrafi 1 1 nenit 7 te LPP —se e parasheh qarte qe "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik ne mënyre te barabarte dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojnë në mënyrë transparente ndërsa AK-ja nuk e ka zbatuar këtë dispozite sepse neve na ka diskriminuar, duke mos na rekomanduar për kontrate. Po ashtu autoriteti kontraktues nuk e ka pasur ne konsiderate edhe nenin 1 te LLP-se pasi qe dihet se qëllimi i këtij ligji është te siguroj mënyrën me efikase, me transparente dhe me te drejte te shfrytëzimit te fondeve publike, burimeve publike si the te gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktues në Republikën e Kosovës, pasi qe ne si pjesëmarrës në këtë aktivitet te prokurimit jemi tenderues i përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët, oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës është ofertë e papërgjegjshme. Provë Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme 1. Përshkruaj specifikimet teknike, në mënyrë jo diskriminuese, karakteristikat e detyrueshme te objektit te kontratës siç janë: Kualiteti, sigurimi i kualitetit, performanca, terminologjia, kërkesat e dizajnit, simbolet, dimensionet, testimi dhe metodat e testimit, sigurimi, paketimi, shënjimi, etiketimi. Specifikimet teknike duhet të përpilohen në mënyrë që të përputhen me qëllimin e prokurimit dhe të ofrojnë qasje sa më të madhe te operatorët ekonomik të interesuar. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar te vendosë specifikim teknik qe favorizojnë ose dis-favorizojnë një ose me shume operatorë ekonomik. 2. Nëse variantet lejohen Autoriteti Kontraktues duhet te ceke specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga një variant dhe çdo kërkesë specifike për prezantimin e variantit të tillë janë]. [Indikacion për ndryshimin e datës së fillimit/dorëzimit (nëse zbatohet):] [Fillimi:] < shëno datën > [Dorëzimi:] < shëno datën >, [Informacionet teknike të detajuara mund të shkruhen në gjuhën që zakonisht shfrytëzohet ndërkombëtarisht për teknikën e tillë]. [Tenderuesi duke marrë parasysh përvojën e tij profesionale duhet të hartojnë listën e pjesëve rezervë duke marrë në konsideratë vendet e përdorimit, duhet të tregojnë çmimet për njësi të pjesëve rezervë dhe çmimin total.] Sasia e parashikuar është vetëm sasi Indikative. Devijimi i lejuar nga sasia totale indikative është [+pluse ,- minuse 30 % e vlerës se kontratës. Furnizim me dru për ngrohje të objekteve shkollore. Drutë duhet të jenë të cilesisë së lartë Bung apo Qarr me diametër jo më të vogël se 100mm dhe jo më të madh se 500mm. Me transport , Me sharritje. Drutë duhet të maten ne tokë para se të pranohen nga organi mbikëqyrë sipas skemës. OE duhet te deklarohet se furnizimet do te i kryej sipas kërkesave te njësive kërkuese menjëherë dhe jo me larg se 3 dite nga marrja e porosive. Do te deklarohet se nuk do mbesin asnjë institucion pa dru për neglizhencën e OE. OE duhet te jepe deklarate se posedone se paku 50% e sasisë se kërkuar ne pllace dhe AK ka te drejtën e verifikimit. Sipas kërkesave të specifikuara në këtë aneks (Aneksi 1 Specifikimet Teknike të detyrueshme) kjabat shihet se autoriteti kontraktues Komuna e Klinës ka kërkuar tri lloje të ndryshme të deklaratave që është dashur të dërgohen se bashku me të Witha dokumentet shoqëruese: Operatori ekonomik (OE) duhet të deklarohet se furnizimet do ti kryej sipas kërkesave të njësive kërkuese menjëherë dhe jo më larg — me vonë se tri (3) ditë nga marrja e porosive. Do të deklarohet se nuk do mbesin asnjë institucion pa dru për neglizhencën e operatorit ekonomik (OE). Operatori ekonomik (OE) duhet të jep deklaratë se posedon së paku 50% e sasisë së kërkuar në pllace dhe AK ka të drejtën e verifikimit. Ndërsa ofertës së operatorit ekonomik e cila është propozuar që të shpërblehet me kontratë (NTSH Nazi Travel Prishtinë Republika e Kosovës) i mungojnë dy deklaratata. Pos deklaratës për posedimin e masës drusore Operatori ekonomik (OE) duhet të jep deklaratë se posedon së paku 50% e sasisë së kërkuar në pllace dhe AK ka të drejtën e verifikimit që ia ka bashkangjitur dosjes së tenderit. Kjo deklaratë është dërguar e njëjtë dy herë e skanuar, ku në njërën deklaratë shkruan "Unë i poshtë nënshkruari deklaroi se posedoi masen drusore të kërkuara nga KK Kline prej më shumë se 60% të sasisë". Ndërsa në kopjen tjetër të skanuar të deklaratës së njëjti është e shënuar: OE:N.T. SH. "NAZI TRAVEL" "Deklaron se posedon masen drusore prej me shumë se 50% në depo". Dy

deklaratat tjera të kërkuara i mungojnë: Operatori ekonomik (OE) duhet të deklarohet se furnizimet do ti kryej sipas kërkesave të njëjësive kërkuese menjëherë dhe jo më larg — me vonë se tri (3) ditë nga marrja e porosive. Do të deklarohet se nuk do mbesin asnjë institucion pa dru për neglizhencen e operatorit ekonomik (OE). Shumë kuartë shihet se operatorët ekonomik të interesuar me rastin e dërgimit të ofertave të tyre është dashur, përkatësisht kanë qenë të obliguar që ti plotësojnë tri deklaratat sipas kërkesës së autoritetit kontraktues Komuna e Klinës. Ndërsa operatori ekonomik oferta e të cilit është propozuar të shpërblehet me kontratë për aktivitetin e lart cekur të prokurimit e posedon vetëm një deklaratë. Prandaj oferta e operatorit ekonomik NTSH Nazi Travel Prishtinë Republika e Kosovës është ofertë e papërgjegjshme. Duke pasur para sysh se autoriteti kontraktues kuvendi komunal i Klinës — Zyra e Prokurimit e ka refuzuar kërkesës tonë për rishqyrtim Vendimin - përgjigjen e dhënë nga autoriteti kontraktues Komuna e Kuvendi komunal i Klinës Republika e Kosovës thuhet: "merret e pa pabazuar për arsye se OE. e ka nënshkruar dhe vulosur deklaratën për specifikime teknike dhe se kjo deklaratë e bënë që OE. i ka marrë për sipër të gjitha kërkesat nga njësia kërkuese që janë pjesë e DT" Kështu nga zyra e prokurimit e autoritetit kontraktues nuk kemi pranuar asnjë sqarim të argumentuar që ka të bëjë me kërkesën tonë për rishqyrtim të dërguar në afatin e paraparë ligjorë. Sipas këtij vendimi — përgjigje të cilin e kemi pranuar nga ana e autoritetit kontraktues komuna e Klinës - Zyra e Prokurimit paska mundësi — të drejte me vendosur si të dojë nëse i konvenon të trajtoi ofertë të përgjegjshme vetëm me një deklaratë e nëse nuk i konvenon të kërkoj tri deklaratat ashtu siç është e specifikuar në Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme. Po të ishte ashtu autoriteti kontraktues kuvendi komunal i Klinës Republika e Kosovës do të duhej ta specifikonte kuartë se që të tri deklaratat e kërkuara mund të përfshihen në një deklaratë. Edhe pse i kemi bërë kërkesë autoritetit kontraktues Komuna e Klinës — zyra e prokurimit që të bëjë vlerësimin real të ofertave dhe të konstatoi se oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënie të kontratës është ofertë e papërgjegjshme diçka të tillë nuk kane vepruar. Prandaj kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP) të pajisë me një raport profesional Panelin Shqyrtues të OSHP-së dhe në bazë të dhënave të trajtuara të bie një vendim të arsyeshëm. Çdo justifikim i mundshëm i Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit nuk mund të mbështet me asnjë normë ligjore dhe as etike - profesionale, këtë duhet të ketë parasysh ngase është duke ushtruar një funksion publik që iu është besuar të ushtroni profesionin, të kryej detyrat me kompetencë dhe përgjegjësi, ndershmëri, besnikëri dhe në pajtim me ligjin. Zyrtarit Përgjegjës i Prokurimit i autoritetit kontraktues komuna e Klinës Republika e Kosovës duhet të jetë i vetëdijshëm se mund të ketë pasoja deri të marrja e përkohshme e certifikatës themelore apo të avancuar të profesionalizimit në prokurim si dhe të gjobitet autoriteti kontraktues Komuna Klinës Republika e Kosovës me një shumë të konsiderueshme të mjeteve financiare, (por si duket janë mësuar me paguar gjoba me mjetet tona — taksa paguesve dhe për këtë nuk mërzhiten fare pasi askush nuk përgjigjet për këto shpenzime të pa arsyeshme). KOO procedurë vetëm sa do të zgjatë realizimin i këtij aktivitetit të prokurimit, në tërësi me fajet e autoritetit kontraktues.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE "Aome" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 1, 6, 7, 28, 51, 59 LPP-së si dhe neni 25.9, 40 të Rrpp-së. Prandaj kërkojmë nga Eksperti Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSIIP) të pajisë me një raport profesional Panelin Shqyrtues të OSHP-së dhe në bazë të dhënave të trajtuara të bie një vendim të arsyeshëm të Vendim të Miratohet e bazuar Ankesa e Operatorit Ekonomik "Aome" Sh.P.K. , Gjeravica Prishtinë. Ti rekomandoi autoritetit kontraktues Komuna e Klinës që aktiviteti i lart cekur i prokurimit të rivlerësohet përsëri dhe pas rivlerësimit me kontratë të shpërblehet oferta e operatorit ekonomik "Aome" Sh.P.K. , Gjeravica Prishtinë si ofertë e vetme e përgjegjshme.

Përgjigje ne kërkesën për rishqyrtim: “Pretendimi: Qe OE. duhet te deklarohet se furnizimet do te i kryej sipas kërkesave te njësive kërkuese menjëherë dhe jo ne larg se 3 dite nga marrja e porosive. Do te deklarohet se nuk do mbesin asnjë institucion pa dru për neglizhencën e O.E. OE duhet te jepe deklaratë se posedojnë se paku 50% e sasisë se kërkuar ne pllace dhe AK ka te drejtën e verifikimit Përgjigje: Merret e pa bazuar për arsye se OE ka e ka nënshkruar dhe vulosur deklaratën për specifikime teknike dhe se kjo deklaratë e bene qe OE i ka marre përsipër gjitha kërkesat nga njësia kërkuese qe janë pjese e DT.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 03/10/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0870/2024, ndërsa me datë 10/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0870 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues, që të Refuzohet ankesa e Tenderuesit ankues, “Aome” Sh.P.K. Klinë, e pabazuar, njëherësh propozoj, që të mbetet në fuqi Vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE Nuk Pajtohet lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për te vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore ne kuptim te nenit 24 paragrafi 1 te Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "Aome " Sh.P.K. eksperti shqyrtuese përmes raportit nr. 2024/0870 ka vlerësuar si në vijim:

Konstatimi i parë (I) : “ Eksperti shqyrtues, sipas autorizimit 2024/0870, pas ekzaminimit të tenderit dhe rrjedhës së procedurës së vlerësimit dhe pretendimeve të palës ankuese në ankesë, duke u bazuar ne shkresat e lendes se trajtuar ka konstatuar dhe sqaron me sa vijon: Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 1). Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Qëllimi) është i pa bazuar, sepse me rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues, me të drejtë e ka shpallur fitues, NTSH Nazi Travel Prishtinë, i cili ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmim më të ulët, prej 46,699.50, andaj ky veprim gjatë vlerësimit është në pajtueshmëri me Nenin 1 të LPP-së, citojmë : Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 7): Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, (Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi) është i pabazuar, sepse me

rastin e kontrollimit të Dosjes së tenderit, Njoftimit për Kontratë dhe dokumentacionin të dorëzuar me tender, gjatë procesit të vlerësimit, Autoriteti Kontraktues e ka shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm. Autoriteti Kontraktues me rastin e shpalljes së Tenderuesit NTSH Nazi Travel Prishtinë, fitues për këtë kontratë nuk ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP- së, nuk ka bërë kurrfarë favorizimi të ofertës së tij, i cili sipas vlerësimit nga ana ime është i përgjegjshëm, andaj në këtë rast nuk kemi të bëjë me diskriminimin e tenderuesit ankues. Përgjigje në pretendimin e lartë cekur (Neni 28) Specifikimet teknike, (Neni 59) Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Eksperti shqyrtues, konstaton se ky pretendim i tenderuesit ankues, nuk qëndron, sepse me kontrollimin dhe rrjedhën e këtij aktiviteti të prokurimit të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, Autoriteti Kontraktues e ka bërë Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, në pajtim me neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Pretendimi i tenderuesit ankues, se A.K. e ka shpallur fitues tenderuesin i cili nuk i ka plotësuar tri deklaratat në vijim: OE duhet të deklarohet se furnizimet do të kryej sipas kërkesave të njëjësive kërkuese menjëherë dhe jo me larg se 3 dite nga marrja e porosive, do të deklarohet se nuk do mbesin asnjë institucion pa dru për neglizhencën e OE. OE duhet të jepe deklaratë se posedojme se paku 50% e sasisë së kërkuar në pllacë dhe AK ka të drejtën e verifikimit ky pretendim nuk qëndron, sepse këto deklarata në pajtueshmëri me nenin 51 të LPP-së nuk kanë qenë të vendosura nga AK në Njoftimin për kontratë dhe DT si kriter i përzgjedhjes që një operator ekonomik duhet të përmbush për tu konsideruar i kualifikuar apo i përgjegjshëm. AK, e ka bërë vlerësimin në pajtueshmëri me nenin 56 të LPP-së dhe tenderuesi i propozuar për kontratë i ka plotësuar dhe dorëzuar dokumentet që janë kërkuar në përputhshmëri me kriteret e përzgjedhjes dhe të vendosura në pajtueshmëri me nenet 65-70 të LPP-së. Tenderuesi i propozuar për kontratë NTSH Nazi Travel Prishtinë, në tenderin e vet e ka nënshkruar dhe vulosur Aneksi 1 Specifikimet Teknike të Detyrueshme, i cili është kusht i vendosur nga AK se Operatorët ekonomik duhet ta kryejnë furnizimin sipas kërkesës së AK dhe duhet të posedojnë se paku 50% e sasisë së kërkuar në pllacë. Me nënshkrimin dhe vulosjen e Aneksit 1, tenderuesi është deklaruar dhe pajtuar me kërkesën e AK se do të kryej obligimet ashtu si është kërkuar, eksperti shqyrtues vlerëson se nuk ka shkelje të nenit 28 dhe 59 të LPP-së, sepse është bërë në pajtueshmëri në këtë nen dhe pretendimi i tenderuesit ankues është i vlerësimi pabazuar. Duke u bazuar në fakte të prezantuar në dokumentacionin që kam shqyrtuar, analizuar dhe krahasuar dhe në atë që u tha më lartë në këtë raport, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në pajtueshmëri me LPP-në, duke e shpallur fitues tenderuesin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët, NTSH Nazi Travel Prishtinë.”

#### ***- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –***

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e tyre dhe provat e administruara gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues mendimet e tij janë të pranueshme dhe se Paneli Shqyrtues me të drejtë e mori në konsideratë Raportin e tij me rastin e vendosjes .

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimeve dhe

rekomandimeve në raportin e ekspertit shqyrtues, kontaktimet mund të vertetohen edhe përmes administrimit të ofertes se dorezuar në këtë procedurë. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë të pabazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "Aome" Sh.P.K. të refuzohet si e pabazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur të mbetet në fuqi Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues Komuna e Klinës lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Furnizim me dru për ngrohje në shkolla dhe institucione tjera të Komunës" me numër të prokurimit 634-24-4786-1-2-1.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**
- **OE - " AOME " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: